



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLLOGOC
MUNICIPAL GLLLOGOC
01 Nr. 400/01-7099
Më. 24/02/2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës
Këshilli i Bashkësisë Islame
Nr. 38/2026
Më. 23.02.2026
DRENAS

KOMUNA E DRENASIT

KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME - DRENAS

Duke u bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, të publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008, Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Bashkësisë Islame në Drenas lidhin këtë marrëveshje:

MARRËVESHJE TË MIRËRKUPTIMIT PËR FINANCIM

E hartuar më datë: 03.02.2026, dhe e lidhur ndërmjet palëve:

1. **Komuna e Drenasit** – përfaqësuar nga Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit.
2. **Kryetari i Bashkësisë Islame në Drenas** – përfaqësuar nga Valon Bequku, Kryetar i Bashkësisë Islame në Drenas.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

- 1.1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të Mirëkuptimit është **financimi me mjete financiare nga Komuna e Drenasit** për mbulimin e shërbimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2

Obligimet e Bashkësisë Islame

- 2.1. Këshilli i Bashkësisë Islame në Drenas obligohet që shërbimet e varrimit t'ua ofrojë të gjithë qytetarëve rezidentë të Komunës së Drenasit, duke respektuar bindjen dhe orientimin fetar (islam ose katolik) të secilit qytetar, pa dallim.
- 2.2. Ofrimi i shërbimeve për qytetarët jo-rezidentë të Komunës së Drenasit realizohet vetëm me miratim paraprak të Komunës së Drenasit dhe vetëm nëse kapacitetet financiare dhe teknike e lejojnë realizimin e tyre.

2.3. Në rast se shërbimet u ofrohen qytetarëve rezidentë të Komunës së Drenasit, por varrimi kryhet jashtë territorit të Komunës së Drenasit, familja obligohet të paguajë një pagesë shtesë për hapjen e varrit, e cila nuk mund të jetë më e lartë se vlera e përcaktuar në pikën 1 të paramasës, sipas tabelës së nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.4. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Bashkësisë Islame në Drenas obligohet t'i kryejë shërbimet e riteve fetare dhe të varrimit, ashtu siç janë të përcaktuara në mënyrë të qartë në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i Shërbimit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi</i>	<i>Totali (€)</i>	<i>Besimi fetar Islam</i>	<i>Besimi fetar katolik</i>
1	Hapja e varrit me dimensione 2.20 m gjatësi x 1.2 m thellësi x 0.8 m gjerësi. Varrri duhet të hapet me dorë (mund të përdoret hillti në vendet ku toka është e kategorisë 6 apo 7). Nuk lejohet hapja me automekanizëm.	copë	1	65.00 €	65.00 €	Po	Po
2	Furnizimi me dërrasa për mbulimin e varrit me dimensione: 2.20 m gjatësi x 0.8 m gjerësi x 1.20 m thellësi. Trashësia e dërrasave duhet të jetë 5 cm dhe prej materialit të ahut.	copë	1	35.00 €	35.00 €	Po	Jo
3	Pastrimi i kufomës sipas rregullave islame – përfshirë pastrimin nga personi përgjegjës dhe dezinfektimin e vendit ku pastrohet kufoma me mjete higjienike.	copë	1	50.00 €	50.00 €	Po	Jo
4	Furnizimi dhe rregullimi i qefinit (mbështjellës i veçantë për kufomën sipas parimeve islame), duke përfshirë dorëzat higjienike, pambukun dhe sapunin.	copë	1	20.00 €	20.00 €	Po	Jo
5	Shërbimet e ceremonisë gjatë varrimit (falja e namazit dhe ritualet tjera fetare).	copë	1	30.00 €	30.00 €	Po	Jo

PL

TOTALI				200.00		
				€		

Neni 3

3.1. Shuma e pagesës ose faturës për shërbimet ose ritualet fetare të cekura në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit për financim është 200 € (dyqind euro) për një (1) person.

3.2. Nëse ndonjë nga shërbimet e përcaktuara në tabelën e Nenit 2 të kësaj marrëveshjeje nuk ofrohet ose nuk realizohet, atëherë vlera e atij shërbimi zbritet nga shuma totale. Ky shërbim nuk përfshihet në pagesën përfundimtare.

3.3. Të gjitha këto shërbime ose rituale fetare do të përmbliidhen dhe përshkruhen në një fakturë që Bashkësia Islame në Drenas që do t'ia dorëzojë Komunës së Drenasit për pagesë së bashku me raportin.

3.4. Këshilli i Bashkësisë Islame në Drenas do të përgatisë Raport për rastet duke e bashkangjitur me dokumentet përcjellëse: kopjen e letërnjoftimit të të vdekurit ose Raportin e konstatimit të vdekjes nga Organi kompetent mjekësor.

Neni 4

Obligimet e Komunës

4.1. Komuna e Drenasit merr përsipër të bëjë zotimin e mjeteve dhe pagesat, pas dorëzimit të faturës dhe raportit me shkrim nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Drenas, të vërtetuar nga Menaxhari e projektit që caktohen nga Komuna e Drenasit, për punën/shërbimet/furnizimet e kryera. Mjetet do të lëshohen në xhirollogarinë e Bashkësisë Islame në Drenas.

4.2. Pagesat për shërbimet ose shpenzimet e cekura në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit për financim do të bëhen në fillim të çdo muaji, nga data 01 deri më 10 të muajit vijues.

4.3. Komuna merr përsipër të caktoj menaxherin e projektit.

Neni 5

5.1. Shërbimet e cekura në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit për financim janë pjesë e kësaj marrëveshjeje dhe nuk lidhen në asnjë mënyrë me pagesën e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame në Komunën e Drenasit (çështje që mbetet në raportet e deritanishme të qytetarëve me Bashkësinë Islame).

5.2. Shërbimet shtesë që kërkohen nga familjarët e të vdekurit, të cilat nuk janë të paraparë në këtë marrëveshje, i barten individualisht familjarit të të vdekurit.

Neni 6

Raportimi me shkrim

Menaxheri i projektit të caktuar nga Komuna e Drenasit, në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkësisë Islame në Drenas, kanë për obligim që çdo gjashtë (6) muaj të përgatisin raport me shkrim për Komunën e Drenasit, duke arsyetuar llojet e shpenzimit sipas tabelës në nenin 2,2 , fatura, dëftesa, përkatësisht kuponë në pajtueshmëri me Rregulloren Financiare Nr. 01/2013, MF – shpenzimi i parave publike.

Neni 7

Ndryshimi i marrëveshjes me mirëkuptim

Me pëlqimin paraprak të Bashkësisë Islame në Drenas dhe Komunës së Drenasit, kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet me aneks-marrëveshje nëse është e nevojshme.

Neni 8

Marrëveshja e mirëkuptimit për financim është e lidhur me një afat kohor të caktuar, duke filluar nga **21.02.2026** deri më **20.02.2027**, afat një (1) vjeçar.

Neni 9

Shkëputja e marrëveshjes

Marrëveshja e mirëkuptimit për financim mund të shkëputet njëanshëm nga Komuna e Drenasit me njoftim paraprak me shkrim në afat prej 30 ditësh në rast se Këshilli i Bashkësisë Islame në Drenas nuk e përmbush këtë marrëveshje në përpikëri, ashtu siç është nënshkruar nga palët nënshkruese.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve



Të dy palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit për financim dhe se në rast të një kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim. Në të kundërtën, kompetente për të vendosur do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Drenas.

Neni 11

Numri i kopjeve

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit për financim është hartuar në tre (3) ekzemplarë identikë, ku një (1) ekzemplar do të mbetet te secila palë, ndërsa të tjerët mbeten për nevojat e organit kompetent.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të fillojë të zbatohet nga data: // _____.

Komuna Drenas



Z. Ramiz Lladrovci, Kryetar



Kryetari i Bashkësisë Islame – Dega në Drenas



Valon Bequku

